



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1191/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Selajdin Fanaj, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e LDK-së në Prizren, paraqitur kundër Qendrës të Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Selajdin Fanaj kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Prizren, nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:03 nga Selajdin Fanaj ku ka pretenduar se pas publikimit të rezultateve përfundimtare të QNR-së, nuk më janë përfshirë të gjitha votat në rezultatet përfundimtare. Në këto qendra të votimit nr: 2033a-Zhuri dhe 2059a në Poslisht janë bërë manipulime dhe ndryshime të rezultateve dhe në këtë rast përveç që jam dëmtuar unë, janë dëmtuar edhe shumë kandidat tjerë të LDK-së, thuhet në pretendimet e ankuesit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të kandidatit për anëtar të kuvendit komunal Selajdin Fanaj janë të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi bindëse, për tu vërtetuar për shkeljen e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1191/2013 më datën 06.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.